



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E XI-TË E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRIË,
MBAJTUR MË 24 DHJETOR 2014**

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën **10:08**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Agim Bregaj, Agron Perquku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fatime Haziri, Habib Mustafa, Habibe Gërxhaliu, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rustemi, Selvete Sholla, Syzana Sylja, Shaban Beka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini dhe Xhevahire Selmani.

Munguan: Hysni Gërguri, Qerim Selimi, Shkelzen Feka dhe Zoran Rakic, anëtarë të kuvendit.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin nënkryetari i komunës, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – propozoi për në të “ndryshme” këto pika të rendit të ditës:

- a. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale.
- b. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Vendimit 01Nr. 23/14, dt. 30.01.2014.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit- propozoi që pika nr. 8 e rendit të ditës “Shqyrtimi i Draft-Rregullores për transportin rrugor në territorin e Komunës së Vushtrrisë (shqyrtimi i dytë)” të hiqet nga rendi i ditës, pasi që nuk ka pasur diskutim publik të mirëfilltë për këtë rregullore me rëndësi të veçantë.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi me vota unanime miratoi këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.
2. Shqyrtimi i Propozim-planit të Punës i Kuvendi të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2015.
3. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme për KB Islame në Vushtrri për ndërtimin e xhamisë.
4. Shqyrtimi i Raportit Vjetor për Punën e Komitetit Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
5. Shqyrtimi i Raportit Vjetor për Punën e Komitetit Konsultativ për Arsim, Kulturë, Fe, Sport dhe Rini.
6. Shqyrtimi i Raportit Vjetor për Punën e Komitetit Konsultativ për Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore.
7. Shqyrtimi i Raportit Vjetor për Punën e Komitetit Konsultativ për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.
8. Shqyrtimi i Draft-Planit Lokal të Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Romë dhe Ashkali në Komunën e Vushtrrisë për periudhën 2015-2018.
9. Të ndryshme:
 - a. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale.
 - b. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Vendimit 01Nr. 23/14, dt. 30.01.2014.
 - c. Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.

Aprovohet me vota unanime procesverbali në fjalë, pa vërejtje dhe sugjerime.

2. Shqyrtimi i Propozim-planit të Punës i Kuvendi të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2015.

Safet Osmani, anëtar i kuvendit- propozoi që në planin në fjalë të përfshihet informata tremujore për sigurinë ushqimore nga Drejtoria për Inspektime, pasi që kjo drejtori është hallka e parë e mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit- propozoi që në planin në fjalë për muajin janar të përfshihet Draft-Rregullorja për promovimin dhe fuqizimin e vullnetarizmit të rinjve dhe pjesëmarrjen e rinisë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Aprovohet Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2015, duke inkorporuar në të edhe propozimet e anëtarëve të kuvendit.

3. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme për KB Islame në Vushtrri për ndërtimin e xhamisë.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit- paraqiti sqarime hyrëse lidhur me propozim-vendimin në fjalë.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- lidhur me propozim-vendimin në fjalë, tha se ka paqartësi formale, juridike dhe ligjore, duke shtuar se në fillim ka qenë kërkesa për dhënie me kompensim, kurse tani është kërkesa për dhënie pa kompensim, si dhe mbetet enigmatike çështja e pronarit të tokës që është propozuar për dhënie në shfrytëzim, sepse nuk dihet a mundet me qenë pronar i tokës komisioni për komasacion. Në fund kërkoi sqarim nga Zyra Ligjore e Komunës se propozim-vendimi në fjalë a është bërë konform suazave ligjore.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit- propozoi shtyrjen e propozim-vendimit për një mbledhje tjetër të kuvendit, pasi që në këtë propozim-vendim nuk figuron pronare Komuna e Vushtrrisë, duke shtuar se edhe komisioni i formuar enkas për trajtimin e peticionit për çështjen në fjalë dhe është propozuar solucioni që të shitet prona në lagjen kontestuese ose të bëhet ndërrimi i pronës, por asnjëra nuk ka ndodhur, prandaj pas propozimit të Bashkësisë Islame, KPF-ja ka kërkuar që të bëhet ndërrimi i pronës për ndërtimin e një ambulance në pronën e Bashkësisë Islame tek Kosova Petroli. Në fund propozoi që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës dhe të procedohet për dhënie në shfrytëzim me kompensim.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit- sqaroi se në mbledhjen e fundit KPF-ja ka kërkuar që kjo pronë t'i jepet në shfrytëzim afatgjatë dhe nëse brenda tri viteve nuk fillon investimi, e njëjta pronë i kthehet komunës.

Bedri Dobra, drejtor i DGJKP-së- sqaroi se kjo pronë është pronë komunale, pasi që nuk ka komision privat të komasacionit. Në vazhdim tha se përfaqësuesi e Bashkësisë Islame nuk janë të gatshëm për ndërrim, pasi që ata janë thirrur në një marrëveshje të mëparshme në mes tyre dhe përfaqësuesve të kuvendit dhe kryetarit të komunës.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit- lidhur me propozimin për dhënie të pronës me kompensim, tha se pronari që e ka lëshuar pronën për kryerjen e aktiviteteve fetare, shtoi se nuk beson që pronari në fjalë do të pranohet që e njëjta parcelë të shitet për të bërë ndërrimin e pronave, prandaj kërkoi që para se të merret vendimi duhet të sqarohet gjithçka.

Idriz Muzaqi, udhëheqës i Zyrës Ligjore- tha se pengesë ligjore për procedimin të mëtutjeshëm të propozim-vendimit në fjalë është fakti se në bazë të shkresave të lëndës parcela në fjalë me kulturë është tokë bujqësore e klasit të 5-të, ndërsa ky propozim-vendim ka të bëjë me dhënien në shfrytëzim për ndërtim, prandaj nuk mund të jepet një parcelë për ndërtim, pa u bërë paraprakisht ndërrimi i destinimit të tokës.

Ermal Lahu, anëtar i kuvendit- tha se në takimin në mes të përfaqësuesve të kuvendit, kryetarit të komunës dhe palëve në kontest është arritur pajtimi në parim që parcela t'i jepet në shfrytëzim Këshillit të Bashkësisë Islame, prandaj propozoi që të aprovohet propozim-vendimi në fjalë, në mënyrë që të gjendet një zgjidhje e pranueshme për të gjitha palët.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit- propozoi që të hidhet në votim propozim-vendimi në fjalë duke e hequr fjalinë "për ndërtim të xhamisë".

Idriz Muzaqi, udhëheqës i Zyrës Ligjore- tha se pasi që bëhet fjalë për formën e veçantë të dhënies në shfrytëzim të pronës së komunës, paraprakisht duhet të dihet për çka po jepet në shfrytëzim.

Ergin Sunguri, anëtar i kuvendit- tha se edhe para tre muajve kemi shqyrtuar një peticion të banorëve lidhur me çështjen në fjalë, dhe shtoi se ka nevojë që të ndërtohet në atë vend xhamia. Pastaj tha se materialet që procedohen për kuvend, së pari duhet të trajtohen në Zyrën Ligjore të komunës. Në fund propozoi që të aprovohet propozim-vendimi në fjalë, pasi që është në favor të qytetarëve të lagjes në fjalë.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit- tha se askush prej anëtarëve të kuvendit nuk është kundër dhënies së pronës në fjalë për Bashkësinë Islame, por këtu u ngritën çështje për të

cilat nuk po ka sqarime. Po ashtu tha se prona nuk po dihet se e kujt është, duke shtuar se komisioni nuk mund të jetë pronar i pronës.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit- tha se në takimin në mes të përfaqësuesve të kuvendit të komunës, kryetarit të komunës dhe palëve tjera nuk është arritur marrëveshja ashtu siç u tha më herët, por është diskutuar që të gjendet një modalitet i zgjedhjes, prandaj propozoi që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës, pasi që nuk është në rregull procedimi në këtë formë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 16 vota “për”, 3 “kundër”, të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

Me këtë Vendim jepet në shfrytëzim afatgjatë prona e paluajtshme komunale – pjesë nga parcela kadastrale nr.190, fletëtreguesi nr.204 në sipërfaqe prej 900 m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej 2571 m², ZK Studime e Poshtme, e evidentuar në emër të PSH Komisioni për Komasicion.

Paluajtshmëria e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi i jepet në shfrytëzim pa kompensim në afat prej nëntëdhjetë e nëntë (99) viteve për Këshillin e Bashkësisë Islame në Vushtrri.

Nëse brenda afatit prej tre (3) viteve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi nuk fillon investimi, atëherë ndërpritet (humbet) e drejta e shfrytëzimit të parcelës sipas nenit 1 të këtij Vendimi.

4. Shqyrtimi i Raportit Vjetor për Punën e Komitetit Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit- tha se raporti në fjalë është përgatitur shumë mirë me detaje dhe propozime të qëlluara, si dhe rekomandime të shkëlqyeshme. Po ashtu tha se dëshiron të informohet se a janë duke u implementuar propozimet dhe rekomandimet në fjalë.

Abdullah Klinaku, drejtor i DSHPS-së- lidhur me raportin në fjalë, kërkoi që kur të hartohen raportet vjetore rekomandimet të jenë më të detajuara me qëllim të ndihmës dhe avancimit të shëndetësisë dhe fushës sociale në Vushtrri. Pastaj tha se disa prej rekomandimeve në fjalë janë zbatuar, kurse disa të tjera janë në zbatim e sipër.

Hamit Xhaferi, kryesues i KKSHP-së- paraqiti sqarime shtesë lidhur me raportin në fjalë.

5. Shqyrtimi i Raportit Vjetor për Punën e Komitetit Konsultativ për Arsim, Kulturë, Fe, Sport dhe Rini.

Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit- tha se raporti në fjalë përmban vetëm problemet e identifikuar, por pasi që jeni komitet konsultativ duhet të ofroni mundësi dhe propozime se si t'i tejkalon problemet ekzistuese. Pastaj tha se raportit në fjalë i mungojnë: sa keni ofruar rekomandime dhe sa janë implementuar ato; rezultati i monitorimit është realizuar vetëm në gjimnaz, kurse jo edhe në shkollën e mesme teknike, si dhe në shkollën e mesme të ulët në fshatin Akrashticë. Mandej tha se anketa e realizuar lidhur me profesorët e gjimnazit përbën padrejtësi ndaj profesorëve të cekur, sepse anketa është bërë në mënyrë selektive për një numër të caktuar të profesorëve. Në vazhdim tha se është me rëndësi të dihen raportet e të gjitha komiteteve konsultative me drejtoritë përkatëse, pasi që nga diskutimet e mëparshme u kuptua se nuk ka raporte adekuate mes komiteteve konsultative dhe drejtorive përkatëse, duke shtuar se raportet në fjalë së pari është dashtë të analizohen nëpër drejtoritë kompetente, pastaj të procedohen për kuvend. Në fund tha se komitetet konsultative duhet të kenë përkrahje më të madhe morale dhe materiale nga institucionet komunale për të qenë sa më efikas në punët e tyre.

Selvete Sholla, anëtare e kuvendit- duke iu referuar raportit në fjalë, tha se në këtë raport mungojnë anketat për dy shkollat tjera të cilat në raport përmenden. Pastaj tha se anketa

është shumë e paqartë, për këto arsye: janë dhënë 50 pyetësor, por nuk dihet se nga kush është formuluar pyetësi; për asnjë mësimitdhënës nuk përputhet numri i pyetësorëve me numrin e vlerësimit nga ana e nxënësve. Mandej tha se sa është kjo anketë e saktë tregon edhe fakti se një mësimitdhënës është profesoreshë e psikologjisë, kurse në raport del se është mësimitdhënës e gjuhës shqipe, prandaj pyeti se e njëjta me vlerësim të lartë a është vlerësuar në gjuhën shqipe apo në psikologji. Në vazhdim tha se nuk pajtohet me këtë raport, pasi që janë etiketuar mësimitdhënësit, dhe përmendi rastin e vlerësimit negativ të Rabije Rushitit, pasi që vlerësimet nga Drejtoria Regionale e Arsimit (inspektorët e arsimit) janë mjaft pozitive për mësimitdhënësen në fjalë. Po ashtu tha se befasonet me vlerësimin negativ për profesorin Musa Behrami, pasi që nxënësit e këtij profesori janë studentët më të suksesshëm, ose profesori Hilmi Hajra, autor i librit të kimisë për shkollat e mesme, ish-zëvendës drejtor dhe brenda tre muajve pritët të pensionohet, ndërsa ky komitet e shpërblen në këtë formë, duke e etiketuar pa argumente. Në fund i sugjeroi komitetit në fjalë që të mos merret me vlerësimin e mësimitdhënësve, pasi që ka kush të merret me vlerësimin e tyre.

Ermal Lahu, anëtar i kuvendit- lidhur me raportin në fjalë, tha se anketa për gjimnazin është sjellur, kurse mungojnë anketat për shkollën e mesme teknike dhe për shkollën e mesme të ulët në Akrahticë, kurse në grafikun e paraqitur për gjimnazin ka shumë mangësi, pasi që janë të paraqitur rezultatet vetëm për 24 profesorë, ndërsa gjimnazi ka afër 70 profesorë, prandaj pyeti pse janë seleksionuar vetëm këta profesorë. Po ashtu nuk është cekur numri i nxënësve që janë anketuar, kurse në disa raste grafiku tregon se për një profesor janë përgjigjur 32 nxënës, ndërsa për një profesor është përgjigjur vetëm një nxënës. Në fund tha se nuk është bërë punë e mirë sa i përket vlerësimit të cilësisë së arsimit në gjimnaz.

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit- tha se e kundërshton plotësisht raportin në fjalë, pasi që i njëjti nuk e plotëson as aspektin përmbajtësor dhe as atë teknik, pasi që edhe hulumtimet e bëra janë tendencioze, dhe shtoi se raporti në fjalë ka gabime të rënda edhe drejtshkrimore. Pastaj tha se që nga paslufta Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka bërë përpjekje maksimale për të ruajtur trashëgiminë kulturo-historike të Komunës së Vushtrrisë, por arritjet më të mëdha janë shënuar gjatë mandatit aktual të drejtorisë në fjalë. Po ashtu tha se në bazë të raportit në fjalë, shihet se ky komitet nuk ka bashkëpunuar fare me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, sepse mjafton të përmenden subvencionet për klubet sportive të cilat ndihmojnë masovizimin e sportit. Ndërsa lidhur me anketën e vlerësimit të profesorëve në gjimnaz, tha se mungojnë anketat për dy shkolla, dhe shtoi se nuk dihet se kush janë hartuesit e pyetësorit, si dhe nuk dihet se në cilin aspekt janë vlerësuar mësimitdhënësit. Në fund tha se janë krijuar hapësira për aktivitete të rinjve, si dhe kërkoi nga komiteti në fjalë që ta merr seriozisht punën e vet dhe të bashkëpunon me drejtoritë përkatëse.

Syzana Sylja, anëtare e kuvendit- lidhur me raportin në fjalë, tha se anketa e realizuar për vlerësimin e mësimitdhënësve në gjimnaz ka hasur në disa fakte shqetësuese në raportet mësimitdhënës – nxënës, prandaj pyeti drejtorin e DA-së se si është vlerësuar raporti në fjalë, si dhe a është formuar ndonjë komision për eliminimin e parregullsive eventuale.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit- tha se raporti në fjalë është real dhe anketa e realizuar bazohet në rezultatet e vlerësimeve nga ana e nxënësve. Pastaj tha raporti në fjalë dëshmon guximin qytetar të anëtarëve të komitetit konsultativ, pasi që anketa e ka paraqitur me emra konkret të mësimitdhënësve, edhe pse do të ishte më mirë që me emra konkret mësimitdhënësit të paraqiten vetëm në mbledhjen e KPF-së. Në fund tha se e inkurajon komitetin konsultativ, duke kërkuar nga ta që ta rrisin aktivitetin e tyre edhe në të ardhmen, pasi që në këtë mënyrë do të rritet cilësia e mësimitdhënësve, si dhe do të përmirësohen raportet profesor-nxënës.

Dibran Përçuku, nënkryetar i komunës- tha se rezultat e raportit në fjalë nuk qëndrojnë, pasi që problemet e identifikuar në këtë raport nuk janë të sakta, sepse komiteti në fjalë është dashtë t'i përmend me emra se cilat ndërtesa me vlerë kulturore historike janë të dëmtuara dhe të rrezikuara, sepse e vërteta është se kryetari i komunës, kuvendi i komunës dhe Ministria për Kulturë ka ndërmarrë hapa konkret duke përpiluar listën prej 29 objekteve

dhe lokaliteteve arkeologjike të cilat janë nën mbrojtje të përkohshme në Komunën e Vushtrrisë, prandaj për të gjitha këto objekte dhe lokalitete është investuar për mbrojtjen e tyre, duke shtuar se vetëm brenda këtij viti në trashëgiminë kulturore në Komunën e Vushtrrisë janë investuar 618.794 €, ku kanë participuar: Komuna e Vushtrrisë, CHWB-ja, Ministria e Kulturës dhe Ambasada Amerikane. Pastaj tha se Komuna e Vushtrrisë në bashkëpunim me CHWB-në ka themeluar forumin lokal të trashëgimisë kulturore të Vushtrrisë, i cili ka hartuar planet lokale për trashëgiminë kulturore për periudhën 2012-2015 dhe në kuadër të këtyre planeve janë nxjerr 32 projekte prioritare. Mandej tha se vetëm në këtë vit është investuar në ndërtim dhe renovim në 11 shkolla, në vlerë prej 761.934 €. Ndërsa lidhur me anketën e realizuar, tha se vlerësimin për mësimdhënësit e bën komisioni për vlerësimin e punës në nivel të shkollës dhe Drejtoria për Arsim, duke shtuar se është e papranueshme që të vlerësohen profesorët me nota të dobëta, si dhe është e papranueshme që profesorët janë përmendur me emra, pasi që është dashtë të përmenden vetëm lëndët të cilat i ligjërojnë, ashtu siç është e papranueshme të vlerësohet me notë të dobët profesori Xhabir Haradinaj, kur i njëjti është vlerësuar vazhdimisht pozitivisht nga komisioni për vlerësim dhe nga Drejtoria për Arsim. Gjithashtu tha se nuk pajtohet me konstatimin e raportit që po pengohet sporti, pasi që kuvendi i komunës i ka subvencionuar klubet sportive në vlerë prej 35.000 €, si dhe janë ndërtuar fusha të vogla sportive në 90 % të shkollave të Komunës së Vushtrrisë, po ashtu Palestra Sportive në Komunën e Vushtrrisë është e hapur për të gjitha aktivitetet sportive për të gjitha klubet sportive. Në fund kërkoi nga komiteti në fjalë që herave tjera kur ta hartojnë raporte të konsultohen me drejtoritë përkatëse dhe të paraqiten vërejtjet me qëllim të përmirësimit të gjendjes në fushat përkatëse.

Musaj Tërbunja, drejtor i DA-së- duke iu raportit në fjalë, tha se mënyra e paraqitjes së këtij raporti nga komiteti në fjalë vjen si rezultat i mungesës së përvojës së tyre, pasi që çdo shkollë ka organin që vlerëson mësimdhënësit, prandaj anketa e realizuar në gjimnaz nuk e ka arritur qëllimin e vet, duke shtuar se as rangimin e mësimdhënësve nuk e kanë bërë në mënyrën e duhur, por edhe komiteti në fjalë nuk ka kompetencë për vlerësimin e mësimdhënësve. Në fund kërkoi që komiteti në fjalë të ketë bashkëpunim me Drejtorinë për Arsim në mënyrë që rekomandimet e komitetit të shërbejnë si udhërrëfyes për punën e mëtutjeshme të Drejtorisë për Arsim.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit- paraqiti vërejtje për mungesën e bashkëpunimit në mes të komiteteve këshillëdhënëse dhe drejtorive përkatëse, prandaj kërkoi që në të ardhmen të ketë bashkëpunim më të theksuar mes tyre, në mënyrë që të shmangen situatat e tilla, siç është anketa e realizuar në gjimnaz.

Fatmir Hoxha, kryesues i KKAKFSR-së- paraqiti sqarime shtesë lidhur me vërejtjet e anëtarëve të kuvendit sa i përket raportit në fjalë, duke shtuar se komiteteve këshillëdhënëse nuk iu janë krijuar kushtet për punë nga organet komunale, si dhe përmendi refuzimin e drejtorit të DA-së për pjesëmarrje në mbledhje të komitetit në fjalë.

Musaj Tërbunja, drejtor i DA-së- sqaroi se asnjëherë nuk ka marrë ftesë për mbledhje të komitetit në fjalë. Kurse lidhur me kushtet e punës, premtoi se DA-ja është e gatshme t'ia plotëson kushtet komitetit në fjalë për realizimin e hulumtimeve të mirëfillta, e jo siç është bërë hulumtimi aktual.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit- pyeti kryesuesin e komitetit se a është bërë hulumtimi në fjalë në mënyrë legale?

Dibran Përçuku, nënkryetar i komunës- premtoi se të gjitha kushtet logjistike do t'iu përmbushen komiteteve këshillëdhënëse për ushtrimin e veprimtarisë së tyre.

Fatmir Hoxha, kryesues i KKAKFSR-së- tha se duke u bazuar në udhëzimin administrativ për themelimin dhe funksionimin e komiteteve këshillëdhënëse, hulumtimi ka qenë tërësisht legal.

6. Shqyrtimi i Raportit Vjetor për Punën e Komitetit Konsultativ për Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit- tha se raporti në fjalë është dashtë më tepër të merret me raportimin e tij se a i ka kryer punët konform udhëzimit administrativ, e jo të përshkruaj se si është themeluar komiteti në fjalë. Në këtë raport është dashtë të ceket sa hulumtime janë bërë për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, duke shtuar se komiteti në fjalë është munduar të marrë disa kompetenca të komiteteve tjera konsultative, kur flet për disa çështje të arsimit. **Bashkim Asllani, zv.kryesues i KKDNJBGJ-së**- paraqiti sqarime shtesë lidhur me raportin në fjalë.

7. Shqyrtimi i Raportit Vjetor për Punën e Komitetit Konsultativ për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.

8. Shqyrtimi i Draft-Planit Lokal të Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Romë dhe Ashkali në Komunën e Vushtrrisë për periudhën 2015-2018.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Ipet në diskutim publik Draft- Plani Lokal të Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Romë dhe Ashkali në Komunën e Vushtrrisë për periudhën 2015-2018.

Diskutimi publik fillon nga data 26 dhjetor 2014 dhe zgjatë deri më 14 janar 2015.

9. Të ndryshme:

a. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Ipet në diskutim publik Draft-Rregullorja për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Tarifa Ngarkesa dhe Gjoha Komunale.

Diskutimi publik fillon nga data 26 dhjetor 2014 dhe zgjatë deri më 14 janar 2015.

b. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Vendimit 01Nr. 23/14, dt. 30.01.2014.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 24 vota “për”, 1 “kundër”, të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

Me këtë Vendim ndryshohet dhe plotësohet Vendimi 01Nr.23/14, dt.30.01.2014 për emërimin e anëtarëve të Komitetit për Komunitete me sa vijon:

Emërohet anëtare e Komitetit për Komunitete Javorka Slavic në vend të Bratislav Kosticit.

c. Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit- paraqiti shqetësimin e qytetarëve për këto çështje: në rrugën “Tirana” përballë pastrimit kimik më tepër se dy muaj ka rrjedhje të ujit nga një gyp nëntokësor, ku uji në këtë pjesë rrjedhë poshtë rrugës deri në shesh, dhe rreziku është tani, pasi që pritet që temperaturat të bien nën zero gradë celsius dhe të ketë ngrirje të ujit, ku do të krijohen sipërfaqe të akullit, prandaj për këtë shkak shumë kalimtar mund të aksidentohen nga rrëshqitja që mund ta pësojnë në atë rrugë, duke marrë parasysht që qarkullimi në këtë

pjesë është shumë i dendur, ku ndodhen shumica e kafiterive të qytetit, gjithashtu pronarët e kafiterive në atë pjesë të qytetit ankohen për standarde të dyfishta sa i përket implementimit të Ligjit të Duhanit, pasi që ata thonë që në kafiteritë “te bankat” dhe në pjesë tjera të qytetit të cilat vizitohen kryesisht nga zyrtar komunal ligji kundër duhanit nuk vlenë, dhe se asnjëherë ato kafiteri nuk vizitohen nga inspektoriat; për çmimin e lartë të bukës i cili në Vushtrri është 35 cent, për dallim prej qyteteve tjera si Mitrovica, Prishtina etj, ku çmimi për bukë varion nga 20 deri 25 cent; banorët e banesave kolektive afër komunës që në orët e vona të mbrëmjes qentë endacak bllokojnë hyrjet e këtyre banesave, ku qentë endacak qëndrojnë në koridoret dhe shkallët e këtyre banesave, madje kohëve të fundit ka pasur edhe vërsulje të qenve ndaj qytetarëve – banorë të këtyre banesave, por fatmirësisht deri tash nuk ka pasur banorë të lënduar; përgjatë shtratit të Lumit “Tërstena”, në lagjen “Sylejman Vokshi”, kur bie shi, sistemi i ujërave atmosferike nuk e përballon sasinë e shiut dhe si pasojë rruga vërshohet, por si zgjidhje të përkohshme nga qytetarët është shpuar muri i betonit të lumit “Tërstena”, dhe uji pak a shumë rrjedhë në shtratin e lumit, kurse në atë lagje në shtyllat e ndriçimit janë vjedhur kapakët tek kabllo e rrymës, ku për pasojë kabllo e rrymës qëndrojnë jashtë shtyllave elektrike dhe banorët e asaj pjese, veçanërisht fëmijët janë në rrezik permanent nga rryma elektrike. Në fund kërkoj që urgjentisht të shqyrtohen këto shqetësime dhe të intervenohet në sanimin e këtyre problemeve nga përgjegjësit përkatës.

Ergin Sunguri, anëtar i kuvendit- përsëri ngriti shqetësimin që e ka ngritur para dy mbledhjeve të kuvendit, duke pyetur se drejtoresha e Drejtorisë për Administratë a ka bërë kërkesë tek ministritë kompetente që në ofiqari të punësohen zyrtar nga komuniteti turk.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit- paraqiti përsëri shqetësimin për lagjen e tij, në të cilën vazhdojnë të hedhen mbeturinat dhe asnjëherë nuk pastrohet kjo lagje nga mbeturinat, ku është krijuar një grumbull i madh i mbeturinave. Po ashtu ngriti shqetësimin se në këtë lagje nuk është vendosur akoma ndriçimi publik, prandaj kërkoj që të merren masa për këto çështje. Në vazhdim pyeti se çka po ndodh me Shtëpinë e Mahmut Agë Gjinollit, e cila përkundër renovimit është e shkatërruar nga brenda. Në fund ia tërhoqi vërejtjen kryesuesit të kuvendit pasi që anëtarët e kuvendit po bëjnë lëvizje të shumta gjatë mbajtjes së mbledhjeve të kuvendit, si dhe për zhurmën e madhe që po krijohet.

Mbledhja përfundoi në orën 12:11.

Albanez Tahiraj

Procesmbajtës

Shpëtim Zhegrova

Kryesues i Kuvendit